



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit  
Mbledhja nr. 89

Prishtinë, më 30.12.2016, në orën 19:45

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 1

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj dhe Doruntinë Maloku.

**Munguan:** Albulena Haxhiu, Valdete Bajrami, Pal Lekaj dhe Milena Miliçeviq.

**Mbledhjen e kryesoi,** Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit.

**Nga stafi mbështetës:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 05/L-141 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;
3. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

- 2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 05/L-141 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.**

**Kryesuesja** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 05/L-141 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

*Meqë nuk pati vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

### **Rekomandim**

1. Projektligji nr. 05/L-141 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

### **3. Të ndryshme**

Nuk pati ndonjë pikë për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 19:55.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryesuesja e Komisionit,

---

**Selvije Halimi**